

IMPORTANCE AND IMPACT OF FOREIGN DIRECT INVESTMENT IN KOSOVO

Ruzhdi Kabashi

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, clirimi_r@hotmail.com

Shyqeri Kabashi

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, kbiznesi@gmail.com

Abstract: Foreign Direct Investment (FDI) is a key element in international economic integration. They create direct, stable and long-term links between economies, and allow economies to promote their products in international markets. FDI is also an additional source of investment funding, which with the help of appropriate policies can be an important tool for development. Foreign Direct Investment (FDI) according to the OECD (2008) is defined as a category of cross-border investments made by a resident of an economy (direct investor) with the aim of establishing a fixed interest enterprise (direct investment enterprise) that is located in an economy other than that of the direct investor. The direct investor motivation is a long-term strategic relationship with the direct investment enterprise to ensure a significant degree of influence from the direct investor in the management of the direct investment enterprise. "Stable interest" is established when the direct investor owns at least 10% of the voting power of the direct investment enterprise. Direct investment can allow the direct investor to gain access to the enterprise economy direct investment that he would not otherwise be able to make. The objectives of direct investment are different from those of portfolio investment, where investors generally do not expect to have an impact on the management of the enterprise.

Keywords: FDI, Foreign investment, economy, capital, tax, development.

RËNDËSIA DHE NDIKIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

Ruzhdi Kabashi

Kolegji BIZNESI Prishtinë, clirimi_r@hotmail.com

Shyqeri Kabashi

Kolegji BIZNESI Prishtinë, kbiznesi@gmail.com

Abstrakt: Investimet e Huaja Direkte (IHD) janë një element kyç në integrimin ekonomik ndërkombëtar. Ato krijojnë lidhje të drejtëpërdrejta, të qëndrueshme dhe afatgjata ndërmjet ekonomive, dhe lejojnë ekonomitë të promovojnë produktet e tyre në tregjet ndërkombëtare. IHD janë gjithashtu një burim shtesë financimi për investime, të cilat të ndihmuara nga politikat e duhura mund të jenë një mjet i rëndësishëm për zhvillim.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) sipas OECD (2008)²⁸⁷ përkufizohet si një kategori e investimeve ndërkufitare të bëra nga një banor i një ekonomie (investuesi direkt) me qëllim të krijimit të një ndërmarrje me interes të qëndrueshëm (ndërmarrje e investimit direkt) që është vendosur në një ekonomi tjetër nga ajo e investitorit direkt. Motivimi i investitorit direkt është një marrëdhënie afatgjatë strategjike me ndërmarrjen e investimit direkt për të siguruar një shkallë të konsiderueshme të ndikimit nga investitori direkt në menaxhimin e ndërmarrjes të investimit direkt. "Interesi i qëndrueshëm" vërtetohet kur investitori direkt zotëron të paktën 10% të fuqisë votuese të ndërmarrjes së investimit direkt. Investimet direkte mund të lejojnë investitorin direkt të fitojë qasje në ekonominë e ndërmarrjes investim direkt që përndryshe nuk do të ishte në gjendje të bënte. Objektivat e investimeve direkte janë të ndryshme nga ato të investimeve të portofolit, ku investitorët në përgjithësi nuk presin të kenë ndikim në menaxhimin e ndërmarrjes.

Fjalet Kyqe: IHD, Investime të huaja, ekonomi, kapital, taksa, zhvillim.

1. RËNDËSIA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

Në botën e sotme të globalizuar, rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion, varen nga dy faktorë kryesorë: IHD dhe zhvillimi i NVM-ve. IHD është burimi kryesor i financimeve të jashtme në vendet në zhvillim. Investimet e huaja të drejtëpërdrejta mund të rrisin formacionin e kapitalit fiks dhe ndihmojnë në bilancin e pagesave. Në pikëpamjen e UNCTAD-it, IHD ka potencialin për të gjeneruar punësim,

²⁸⁷ OECD Benchmark Definition of Foreign Direct Investment FOURTH EDITION 2008 <http://www.oecd.org/fq>. 17.

rritje të prodhueshmërisë, aftësi transferuese dhe teknologji të re, rritjen e eksporteve, si dhe kontribuon në zhvillim afatgjatë ekonomik të vendeve të zhvillim.²⁸⁸

Stoku i brendshëm i IDH-së në vendet në zhvillim (stoku i brendshëm IHD kuptohet si sasia kumulative e investimeve të drejtpërdrejta të regjistruara nga investues të rinj dhe ekzistues) ishte rreth një e treta e PBB-së së tyre; një rritje domethënëse krahasuar me 10% në 1980. Ekonomistët debatojnë nëse është IHD që gjeneron rritje ekonomike, apo është rritja ekonomike që gjeneron IHD. Konstantja, që shfaqet nga ky debat akademik, është se rritja e IHD-së dhe rritja ekonomike piren të shoqërojnë njëra-tjetrën.

Nga pikëpamja e ofertës, IHD varet nga disponibiliteti i kapitalit investues i gjeneruar nga fitimet e përbashkëta ose huat, të cilat vetë varen nga kushtet vendëse ekonomike, përfshi rritjen. Nga pikëpamja e kërkesës, zgjerimi i tregjeve në vende të huaja bën që TNC-të (Korporatat Ndërnacionale) të investojnë më tepër, ndërkohë që tregjet e tkurrura i frenojnë. Gjatë dy dekadave të fundit, bumet në IHD globale kanë ardhur pas periudhave të rritjeve të larta ekonomike, ndërsa rëniet kanë ardhur pas rënieve ose rritjeve të ngadalta. Prirjet e fundme ekonomike pozitive sugjerojnë që rritja e IHD-së vjen pas rënies së investimeve. Premisat e ekonomive në zhvillim dhe në tranzicion janë të mira.

Sipas Bankës Botërore, Azia Jugore, Azia Lindore, Evropa Lindore dhe Azia Qendrore priten të kenë rritje me mbi 55%. Çdo rajon tjetër në zhvillim pritet të zgjerohet në shifrat ndërmjet 3.5 deri në 5% në vit. Për të mbështetur investimet, është e rëndësishme që të vendosen themelet makroekonomike dhe të nxitet klima e favorshme për investime.

Ndërsa sipas Institutit Riinvest, Investimet e Huaja Direkte (IHD) kanë një rëndësi të pasaçme dhe specifike për Kosovën duke pasur parasysh kushtet në të cilat duhet të realizohet zhvillimi ekonomik. Situata specifike e Kosovës në këtë aspekt ka të bëjë sidomos me:²⁸⁹

- Sistemi i Bankave në Kosovë ende nuk është i aftësuar për livrimin e kredive aftagjata dhe në vëllim më të madh për të mbështetur investime me serioze,
- Mungesa e tregut financiar dhe tregut të letrave me vlerë,
- Zbatimi i procesit të privatizimit i cili synon të tërheq investitor të jashtëm,
- Dërgesat financiare – remitancat, nga emigrantët Kosovar në Europën Perendimore dhe SHBA pritet të zvogëlohen në kushtet kur shumë Kosovar po tërheqin familjet e tyre në vendet ku janë vendosur,
- Nevojat e mëdha për investime në infrastrukturën publike dhe në sektorët e tjerë për krijimin e vendeve të punës dhe përballimin e problemit të papunësisë,
- Niveli i papunësisë i lartë. Duke pasur parasysh këto fakte është e qartë se Kosova ballafaqohet me burime të reduktura për financimin e investimeve, në kushtet kur domosdo përballet me presionin dhe nevojën imanente për të zgjidhur problemin e papunësisë dhe për të përmisuar infrastrukturën publike (norma e vlerësuar e papunësisë 45-50%). Gjendja aktuale në sektorin e energjetikës, telekomunikimeve dhe transportit rrugor mund të konsiderohet si faktorë limitues në zhvillim që tani.

Aktiviteti investues i bizneseve private në periudhen e pasluftës ka gjeneruar rritje të konsiderueshme ekonomike dhe të punësimit, por që tani vërehen shenja të recesionit në kuptim të rënies së vëllimit të qarkullimit mesatarë për një ndërmarrje dhe rritjes së punësimit. Në këto kushte, krijuesit e politikave ekonomike sfidohen me nevojën e nxitjes së investimeve të reja. Prandaj krijimi i një ambienti miqësor afarist dhe ambientit adekuat institucional për tërheqjen e investimeve të jashtme direkte imponohet si një nga prioritetet më të rëndësishme të politikave ekonomike dhe reformës ekonomike. Është e kuptueshme se vetëm IHD nuk mund t'i shpejtojnë aktivitetet mëse të domosdoshme investuese. Synimi duhet të jetë që ato të bëhen një burim i rëndësishëm dhe komplementar me burimet e tjera të financimit.

2. MUNDËSITË E PËRFITIMIT TË KOSOVËS NGA IHD-TË

IHD-te janë mjet i rëndësishëm për adoptimin e teknologjive të reja. Sipas prezantimeve të qeverisë Kosova ka avantazhet e saj për të tërhequr investitor për faktin se ka një popullatë të re, ligjet e përafërta me ato të Bashkimit Evropian, pozitë gjeostrategjike të favorshme, taksat të ulëta, lehtësime për të depërtuar në tregjet BE-së dhe të SHBA-ve, CEFTA etj, por duhet të krijoj dhe lehtësime të tjera në mënyrë që të ketë investime të vazhdueshme edhe në sektorët e tjerë e jo vetëm në sektorët që aktualisht janë atraksion për IHD-të. Investimet e huaja direkte kanë rëndësi të veçantë për vendin pritis për faktin se ato ulin mundësinë e borxhit publik. Ardhja e investitorëve me vete sjellë edhe përvojat e vendeve të tyre, si dhe krijojnë mundësi dhe forma të reja të menaxhimit për vendet pritëse. Kompanitë shumëkombëshe janë forma e biznesit që bart globalizimin në mbarë botën, dhe IHD-të janë një metodë e rëndësishme që shfrytëzojnë firmat për strategjitë e tyre të rritjes globale (O, Shenkar, 2007). Sektorët, që më së

²⁸⁸ <http://www.osce.org/sq/eea/19771?download=true> fq 18

²⁸⁹ Riinvest Anketa e NVM, 1999, 2000, 2002

shumti janë duke lulëzuar në Kosovë, janë ata të ndërtimit, telekomunikacionit, financiar etj. Bilanci i investimeve të huaja direkte në Kosovë, i matur nga investimet e bëra në Kosovë dhe investimeve të rezidentëve të Kosovës në vende tjera, për periudhën 2012 ishte 42.9% krahasuar me vitin paraprak 2011 me 41.2% që do të thotë se ka pasur një rritje të lehtë të investimeve të huaja krahasuar me vitin paraprak. IHD-të në Kosovë nëpër periudha të caktuara kanë ndryshuar p.sh. për vitin 2012 përqindja e investimeve në sektorët ekonomikë (BQK) është: patundshmëria me 31.7%, ndërtimtaria me 20.8%, prodhimtaria me 12.1%, sektori financiar me 10.4%, sektori i transportit dhe telekomunikacionit me 7.9%. IHD-të nuk do të thotë që gjithmonë pasqyrojnë stabilitet makroekonomik por është aktor i cili e luan rolin e tij në këtë pjesë gjë që mund të themi se është i kënaqshëm për shkak se e ul borxhin publik. Investimet e huaja direkte zakonisht më shumë koncentrohen nëpër vende që janë në zhvillim se sanë vendet që janë të zhvilluara për faktin se edhe përfitimet janë më të mëdha dhe shumë dimensionale për vendin pritës të këtyre investimeve po ashtu e dhe për investitorin. Procesi i privatizimit ka thithur IHD-të në Kosovë në masë të madhe, kësaj i ka kontribuar gjithashtu anëtarësimin në CEFTA. Kosova pas anëtarësimit në CEFTA ka ndikuar pak a shumë por jo sipas pritshmërisë pasi siç vërehet marrëdhëniet tregtare të Kosovës janë kryesisht me vendet e BE-së, pra Kosova më shumë eksporton në vendet e BE-së se sa në vendet anëtare të CEFTA-së. Sistemi financiar i Kosovës ka stabilitet të qëndrueshëm kjo u vërejtë në vitin 2008 ku kriza goditi edhe vendet me një zhvillim të qëndrueshëm por ndikimi i saj nuk ka pasur efekt direkt në Kosovë. Argumentimi se përse një investitorë duhet ta zgjedhë Kosovën si destinacion për të investuar qëndron në atë se: Kosova posedon fuqi punëtore të kualifikuar, posedon popullsinë më të re në Evropë ku moshë mesatare llogaritet të jetë 25 vjet, Përdorimi i valutës Euro që është një përparësi, Pozitë strategjike dhe gjeopolitike ndodhet në qendër të Ballkanit, Norma të ulëta të TVSH-së dhe tatimit në fitim, Mundësi për qasje të lehtë në tregjet e BE-së, SHBA-së dhe CEFTA-së, Stabilitet ekonomik kjo u dëshmuar në krizën e fundit të vitit 2008, Legjislacion të përafërta me BE-në etj. Promovimi i investimeve mund të shihet si "marketing" i vendit pritës pasi që si vend i mundshëm pritës për IHD-të mund të ndikoj që investitorët e mundshëm të vendosin për të investuar. Kjo është veçanërisht e dobishme kur vendi është i panjohur ose perceptuar si jo tërheqës për investitorët, pasi ka përmirësuar kornizën e politikave të IHD-ve, ose nëse një vend dëshiron të tërheqë vëmendjen e një investitori të caktuar, apo të synuar. Aktivitetet promovuese, fushatat informative dhe reklamuese zakonisht ndërmerren nga Agjencitë për Promovimin e Investimeve, qëllimi i së cilës nuk është vetëm ndërtimi i imazhit "miqësor për investime" të vendit, por edhe për të ndihmuar investitorët potencialë për të zbuluar mundësitë e investimeve në zhvillim.

3. NDIKIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

Pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit ekonomik, vendet janë të orientuara në drejtim të krijimit të politikave ekonomike që nxisin tërheqjen e IHD-ve. Ata duan të kuptojnë përfitimet nga IHD-të. Është e njohur se IHD-të mund të inkurajojnë zhvillimin ekonomik të vendeve duke bërë që kompania të bëhet më konkurruese, duke sjellë kapital të ri, teknologji të re dhe rritje të punësimit. Procesi i globalizimit ka ndikim të jashtëzakonshëm në përhapjen dhe rritjen e investimeve të huaja direkte. Sot ndërmarrjet janë më agresive se kurrë më parë në tregun global.²⁹⁰

Një nga strategjitë për të hyrë firma në tregun global është IHD. Koncepti i IHD-ve dhe tregtisë janë në koherencë me njëratjetren. Pikëpamja se investimet janë pozitive për zhvillim ekonomik bazohet në idenë se investimet mund të gjenë efektë pozitive në zhvillimin ekonomik përmes kanaleve të ndryshme. Nëse ndërmarrja e huaj në aspektin e teknologjisë është me e përdorur se sa shumica e ndërmarrjeve vendore, ndërmjetesimi i teknikave, inxhinereve dhe menaxhereve të jashtëm në ndërmarrjet vendore mund të rezultojë me bartjen e njohurive nëse ndërmarrjet e jashtme aftësojnë punëtorë që në një të ardhme mund të jenë punëtorë të ndërmarrjeve vendore²⁹¹.

Stabiliteti makroekonomik dhe rritja ekonomike janë thelbësore për nxitjen e zhvillimit ekonomik. Për investuesit e kompanive, treguesit më të rëndësishëm të stabilitetit makroekonomik janë ata që ndikojnë drejtpërdrejt në bilancet e tyre si për shembull rritja e PBB-së dhe e PBB-së për frymë, inflacioni, rritja e popullsisë dhe shkalla e arsimit universitar. Gjithashtu, kursi i interesave është shumë i rëndësishëm për NVM-të dhe disa investues të huaj. Hapja e një shteti ndaj tregtisë me jashtë, investuesit të huaj dhe punëtorëve të huaj, ndikon në suksesin e tij në nxitjen e zhvillimit ekonomik. Nëse shtetet me burime të bollshme natyrore duan të zgjerojnë rrezet e pasurisë dhe të zbutin tronditjen nga ndryshimet brenda një industrie, ata duhet të diversifikojnë ekonomitë e tyre. Vendet duhet të miratojnë strategji ekonomike afatmesme, politika fiskale të disiplinuar dhe një qasje të hapur ndaj tregtisë me jashtë dhe flukseve të kapitalit nga tregjet ndërkombëtare.²⁹²

²⁹⁰ Nasir Selimi, Kushtrim Reci, Luljeta Sadiku, "The Impact of Foreign Direct Investment on the Export Performance: Empirical Evidence for Western Balkan Countries".

²⁹¹ Nerimane BAJRAKTARI, Arbër NIMANI, Phd (c), "Roli dhe Rëndësia e Investimeve në Kosovë" fq 627 revistë shkencore

²⁹² Udhëzuesi I praktikave më të mira për një klimë pozitive për Biznesin dhe investimet (OSCE).

Transaksionet tregtare dhe investimet e huaja direkte janë faktorët më të rëndësishëm në përpunimin e rritjes ekonomike të çdo vendi. Hapja e praktikave tregut në rritjen ekonomike është kryesisht për shkak të akumulimit të kapitalit natyror dhe transferimit të teknologjisë.²⁹³ Roli i investimeve të huaja në stimulimin e zhvillimit ekonomik është përcaktuar mirë (Handjiski 2009).

IHD-të kanë qenë shtyllë e rëndësishme e strategjisë së zhvillimit në shumë shtete, dhe ka luajtur rol edhe më të madh në ekonomitë në tranzicion që kanë pasur sukses në privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore me kapital të huaj. Qeveria e Kosovës ka vënë rritjen ekonomike si prioritetin e saj kryesor dhe është duke synuar kah IHD-të si kontribuues kryesor. IHD-të në Kosovë kanë qenë shumë të ulëta në periudhën pas konfliktit, duke arritur shumën prej më pak se 400 milion (Banka Qendrore e Kosovës) ndërmjet 2000 dhe 2005, dhe rreth gjysma e këtij investimi vjen nga privatizimi.²⁹⁴ Ka pasur hulumtime të gjera për kontributin e IHD-së në zhvillimin ekonomik. Investimet e brendshme mund të sjellin shumë përfitime të zhvillimit ekonomik për një komunë. Disa nga përfitimet kyçe potenciale janë dhënë më poshtë:²⁹⁵

- Krijimin e vendeve të punës
- Qasja në tregun e eksportimit
- Produktivitet më i lartë
- Qasje në teknologji
- Novacion
- Shkëmbimi i jashtëm
- Kategoria e pagave.

4. ARSYET PËR TË INVESTUAR NË KOSOVË

Disa nga përfitimet për të investuar në Kosovë janë:²⁹⁶

- Taksat në Kosovë janë shumë të ulëta krahasuar me shtetet fqinjë;
- Sistemi tatimor është mbajtur jashtëzakonisht i thjeshtë;
- Popullata – e re dhe e motivuar, 70% nën moshën 35 vjeçare;
- Një fuqi të re dhe të motivuar punëtoare me shpirt dhe aftësi të forta ndërmarrëse dhe gjithashtu njohuri të përgjithshme të shumicës së gjuhëve Evropiane;
- Resurset e lakmueshme natyrore: linjiti, zinku, plumbi, feronikeli dhe toka pjellore bujqësore;
- Qasje të lirë në tregun e Bashkimit Evropian dhe tregjet fqinjë;
- Institucione moderne në përkrahjen e bizneseve;
- Procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë për regjistrimin e bizneseve (brenda ditës);
- Sistem të sigurtë bankar;
- Strukturë moderne ligjore dhe në pajtim me BE-në;
- Monedha zyrtare në Kosovë është Euro, që eliminon rrezikun e Euro-zonave.

Pas pavarësisht të saj, Kosova ka arritur progres të madh në shumë fusha të zhvillimit të saj si në: rritjen e stabilitetit politik, ngritjen e nivelit të sigurisë, ekonomi stabile me rritje të vazhdueshme, plotësim të legjislacionit etj. Ajo është bërë pjesë e rëndësishme e iniciativave të bashkëpunimit rajonal, përmes të cilave është arritur krijimi i tregut të përbashkët rajonal, eliminimi i tarifave doganore, eliminimi i barrierave tregtare, si dhe hapja e perspektivave të reja. Institucionet e Kosovës kanë punuar dhe vazhdojnë me hapa të shpejtë të punojnë në përmirësimin e standardeve të nevojshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Është krijuar mjedis stabil makroekonomik, sistem i qëndrueshëm financiar, janë bërë reforma në politikën fiskale në aplikimin e normave më të ulëta tatimore në rajon.

Ndër objektivat e rëndësishme që vendi ynë ka vënë para vetës është edhe rritja e konkurrencës së ekonomisë së vendit në tregun rajonal. Është arritur progres në ngritjen e infrastrukturës moderne, si brenda Kosovës e po ashtu edhe në lidhjen me rajonin, vlen të përmendet këtu lidhja me Shqipërinë përmes autostradës së ndërtuar, si dhe zotimet e Shqipërisë që në një të ardhme jo të largët të ndërtoj edhe vijën hekurudhore që lidh këto dy vende. Vendi ynë ofron mundësi të mëdha për investim edhe në sektorë tjerë si në: bujqësi, energji, vreshtari, turizëm, nxjerrje dhe përpunim të metaleve etj. Sistemi i regjistrimit të biznesit në Kosovë përbën një faktor tjetër nxitës në rritjen e investimeve, me procedurë të thjeshtuara dhe me shpejtësi të regjistrimit të bizneseve të reja për një kohë të

²⁹³ Chaido Dritsaki, Emmanouil Stiakakis “Foreign Direct Investments, Exports, and Economic Growth” in Croatia: A Time Series Analysis”

²⁹⁴ Raport nr. 53185-XK, KOSOVA “Zhblllokimi i potencialit për rritje ekonomike: strategjitë, politikat, veprimet” Memorandumi ekonomik i shtetit fq.28

²⁹⁵ USAID, Udhëzime për promovimin e investimeve nga Qeveritë lokale në Kosovë

²⁹⁶ Ministria e Integrimit Evropian <http://www.mfa-ks.net/>? page 119

shkurtë. Të gjitha këto e veçojnë Kosovën si një vend mjaft atraktiv me mundësi investimi për secilin investitor të sektorëve të ndryshëm, si në privatizim ku tashmë pritet privatizimi dhe dhënia në koncesion e kompanive të mëdha publike, po ashtu edhe investimi në fushat e gjelbërta, në të cilat mundësi mjaftë të favorshme në ofrimin e infrastrukturës fizike ofrojnë paraqet industriale. Kosova, po punon në krijimin tregut të kapitalit financiar, në të cilin do të gjenin plasman investitorët, të cilët duan të investojnë në aksionet e kompanive të ndryshme.

5. SHUMA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

Në vazhdim paraqiten shumatat e investimeve të huaja direkte në Kosovë nga viti 2007 deri në vitin 2020. Të dhënat janë marrë nga raportet e bankës qendrore të Kosovës.

Investimet e huaja direkte në Kosovë gjatë periudhes 2007 – 2020

| | |
|---------------------------|-------|
| | |
| 2007 | 440,7 |
| 2008 | 369,9 |
| 2009 | 287,4 |
| 2010 | 368,5 |
| 2011 | 384,4 |
| 2012 | 229,1 |
| 2013 | 280,2 |
| 2014 | 151,2 |
| 2015 | 308,8 |
| 2016 | 215,9 |
| 2017 | 213,7 |
| 2018 | 287,8 |
| 2019 | 271,8 |
| 2020 Janar-Qershor | 164,7 |

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Investimet e jashtme direkte në Kosovë kanë filluar që pas vitit 2000 ndërkaq investimet më voluminoze janë bërë në vitet 2007-2008. Investimet e mëdha të viteve 2007-2008 i dedikohen investimet në telefonin e dytë mobile në Kosovë. Rënia e investimeve të jashtme direkte u vërejt nga fundi i vitit 2008 dhe fillimi i vitit 2009 nga kriza ekonomike globale ku investimet e jashtme patën rënie drastike. Ndërkaq më 2010- 2011 filloi rritja e investimeve edhe pse me një ritëm shumë të ngadalshëm. Në vitin 2012 IHD financon llogarinë rrjedhëse me 60%, në 2013 me 76%. Mesatarja (2008-2013) e financimit të llogarisë rrjedhëse nga IHD është 71%. Efekti i krizës zgjerohet sidomos në vitin 2012 me rënie të madhe minus 40 % të IHD-së apo vetëm 229.1 mil. euro, ndërsa 2013 me 280.2 mil. ose 22 % më shumë se vitin paraprak. Viti 2014 shënon një rënie prej 46% krahasuar me vitin paraprak ose 151.2 mil. euro. Viti 2015 vazhdon me një rritje prej 308.8 mil. euro. Ndërsa në vitin 2016 kemi një trend rënës prej 215.9 mil. euro. Po ashtu edhe viti 2017 ka një trend rënës prej 213.7 mil. Euro ose 2.2 mil. euro me pak. Ndërsa viti 2018 ka një trend rritës prej 287.8 mil. Euro ose 74.1 milion më shume se viti paraprak. Viti 2019 vazhdom me një trend rënës prej 271.8 mil. Euro apo 16 mil. euro më pak se periudha paraprake. Gjatë vitit 2020 prej janarit deri në qershor të këtij viti, këto investime kanë arritur vlerën e 164.7 mil. euro dhe na jep nje rezultat pozitiv krahasuar me periudhen e njejtë të vitit paraprak. Këto investime ende vazhdojnë të jenë të ndikuara nga zhvillimet ekonomike në botë konkretisht në eurozonë. Kriza ekonomike në eurozonë ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në numrin e investimeve në Kosovë, arsyeja është e thjeshtë ngase si në rastin e krizës globale ashtu edhe në këtë të eurozonës, kur investitorët e mundshëm të jashtëm në vendet e tyre kanë kriza, atëherë automatikisht bie edhe mundësia dhe dëshira që ata të investojnë në vende të tjera, në këtë rast në Kosovë. Ndikimi i vetëm i krizës globale në Kosovë sipas FMN-së ishte kufizimi i integritimit në tregjet globale.

6. KONKLUZION

IHD-të mbesin një nga kategoritë ekonomike më të rëndësishme dhe njëherazi më të përfolura nga akterë të ndryshëm politik, profesionistë të ekonomisë, gazetarë, student, etj. Sidoqoftë, në literaturën shqipe IHD-të në shumicën e rasteve përmenden në kontekstin statistikor, kurse shumë pak është punuar në drejtim të shpjegimeve teorike të kësaj kategorie ekonomike. Sipas hulumtimeve të deritashme del se IHD-të janë faktor i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, kjo për shkak se IHD-të financojnë sektorët strategjike ekonomik, si: sektorët e patundshmërisë, ndërtimit, prodhimit, sistemit financiar, telekomunikacionin, etj. IHD-të kanë rëndësi për çdo vend kudo që ndodhin ato, gjithashtu rëndësi kanë edhe për Kosovën, e cila është duke kaluar në një tranzicion ekonomik dhe politik, duke kaluar nga një sistem në të cilin ishte në kapitalizem. IHD-të në Kosovë kanë ndodhë që nga periudha e pasluftës por jo në fluks të kënaqshëm dhe ndoshta jo në formë të IHD-ve. Sidomos pas definimit të statusit kanë ndodhur investime më të theksuara sepse edhe siguria ka qenë pak më e madhe për shkak se investitorët kanë e kanë ndier vetën më të sigurt për të bërë investime këtu.

Investimet e huaja direkte janë një mënyrë e shëndetshme për të zhvilluar një ekonomi në tranzicion siç është Kosova, duke pasur qëllim krijimin e vendeve të reja të punës dhe avancimin e teknologjisë. Në këto situata, këto kompani të huaja përfitojnë po ashtu duke hyrë në tregje të reja, që do të thotë promovim të bizneseve përkatëse, duke rezultuar në prodhim më të lirë, për shkak të kostove më të ulëta të fuqisë punëtore në Kosovë. Përfitimet e IHD-ve nuk rriten automatikisht dhe në mënyrë të barabartë në vende, sektorë dhe Komunitete lokale. Politikat kombëtare dhe arkitektura ndërkombëtare e investimeve janë çështje për tërheqjen e IHD-ve në një numër më të madh të vendeve në zhvillim dhe për korrijen e përfitimeve të plota të IHD-ve për zhvillim. Sfidat kryesisht adresohen tek vendet pritëse, të cilat duhet të krijojnë një transparencë, gjerësi dhe efektivitet duke mundësuar mjedisin e politikave për investime. Kosova do të përfitojë shumë nga investimet e huaja direkte (IHD). Kosova ka potencial të madh për t'u bërë një destinacion i favorizuar për IHD-të.

LITERATURA

- Bajraktari, N., & Nimani, A. (n.d.). "Roli dhe Rëndësia e Investimeve në Kosovë" fq 627 revistë shkencore
- Bunjaku, F. (2016). Investimet e Huaja Direkte (Aspekte Teorike dhe Analizë Kritike). Prishtinë, 2016, fq.11
- Conahan, K., Deichmann, J. I., Krasniqi, B. A., & Peci, F. FDI in Kosovo. Foreign Direct Investment in the Successor States of Yugoslavia, 195-212.
- Dritsaki, C., & Stiakakis, E. (n.d.). "Foreign Direct Investments, Exports, and Economic Growth" in Croatia: A Time Series Analysis"
- Gashi, P. (2017). Free Trade and FDI in Kosovo: Prospects for Integration into the EU and Turkish Production Networks. Turkish Economic Review, 4(1), 86-95.
- Kristo, I. (n.d.). Biznesi Ndërkombëtar, Botimi i Dytë, fq 264
- OECD Benchmark Definition of Foreign Direct Investment FOURTH EDITION 2008 <http://www.oecd.org/> fq. 17.
- Sahiti, A., Sahiti, A., & Zeqiri, R. (2020). The Determinants of Foreign Direct Investment: Empirical Evidence from Kosovo. Advances in Business Related Scientific Research Journal (2020), 11(1), 67-76.
- Sahiti, A., Ahmeti, A., & Sahiti, A. (2020). FDI Trends and Characteristics in Kosovo. Baltic Journal of Real Estate Economics and Construction Management, 8(1), 12-21.
- Selimi, N., Reci, K., & Sadiku, L. (n.d.). The Impact of Foreign Direct Investment on the Export Performance: Empirical Evidence for Western Balkan Countries".
- <http://www.osce.org/sq/eea/19771?download=true> fq 18
- Riinvest Anketa e NVM, 1999, 2000, 2002
- Udhëzuesi i praktikave më të mira për një klimë pozitive për Biznesin dhe investimet (OSCE).
- Raport nr. 53185-XK, KOSOVA "Zhbllokimi i potencialit për rritje ekonomike: strategjitë, politikat, veprimet" Memorandumi ekonomik i shtetit fq.28
- USAID, Udhëzime për promovimin e investimeve nga Qeveritë lokale në Kosovë
- Ministria e Integritimit Evropian <http://www.mfa-ks.net/> page 119